



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.134/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.134/2025 e datës 22.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane, paraqitur kundër Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 22.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane, ku pretendohet se kryetari i partisë Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, në të cilën theksohet se më datën 21.01.2025, në profilin e tij në facebook ka publikuar një video incizim përkatësisht Spot Politik, ku shihen fëmijët e moshës nën 16 vjeçare, në këtë mënyrë Elbert Krasniqi, në cilësi të kryetarit të IRDK-së, në këtë incizim ka keqpërdorur fëmijët e mitur kinse duke treguar për të arriturat gjatë mandatit të tij si ministër i MAPL-së.

Më tej në ankesë thuhet se me këto veprime i njëjti, ka keqpërdorur fëmijët e mitur, sidomos ata të moshës nën 16 vjeçare, duke e ditur se fëmijët janë kategori e ndjeshme e shoqërisë dhe ekspozimi i tyre është i kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 45, par.3 të Ligjit NR. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijëve, që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve në masmedia, ashtu që me këtë nen është e përcaktuar se "Mjetet e komunikimit masiv, përfshirë mediat e shkruara dhe elektronike, botimet, televizionin, radion, reklamat, kinemanë, internetin dhe mediat online, portalet, janë të obliguara që të kontribuojnë në mënyrë aktive për të afirmuar mbrojtjen e fëmijës me realizimin e veprimtarive vetë dijesuese dhe duke këshilluar publikun mbi ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj mediave mund të ketë mbi fëmijën".

Në përgjigjen në ankesë të Elbert Krasniqi, Kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK, përfaqësuar nga Eros Gashi, i kundërshton si të paqëndrueshme pretendimet e palës ankuese, edhe atë për shkak se.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese se Elbert Krasniqi, Kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK, ka kryer shkelje duke vepruar në kundërshtim me nenin 45, par. 3 të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës; shqyrtimi i kësaj çështje është jashtë juridiksionit të PZAP, kjo pasi që PZAP është organ i përhershëm, i pavarur dhe kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe me Rregullat zgjedhore, ashtu që PZAP mund të vendos për ankesa lidhur me çështjet e përcaktuara taksativisht me këto akte ligjore e nënligjore dhe jo bazuar në Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.

Ndërsa sa i përket pretendimit të palës ankuese se Elbert Krasniqi, Kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK, ka kryer shkelje duke vepruar në kundërshtim me nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore, Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve"; i njëjti pretendim nuk qëndron, pasi që në pamjet e video incizimeve, me mbishkrimin "Voto 111", numër me të cilin IRDK garon në Zgjedhjet Parlamentare: a) janë ekspozuar foto të realizuara nga aktivitetet zyrtare të MAPL dhe jo nga fushata, respektivisht të njëjtat janë foto nga inaugurimi i projektit "komunat për të rinjtë" dt. 22.12.2022 dhe dt. 31.04.2024;

PROVÉ: Fotot e postimeve të ministrit Elbert Krasniqi dt. 22.12.2022 dhe dt. 31.04.2024; të njëjtat foto kanë marrë karakter publik që nga ajo datë dhe nuk janë kundërshtuar nga personat e autorizuar që kanë dhënë pëlqimin dhe b) të njëjtat nuk përfshijnë veprime, akte, shenja, apo forma të tjera të mbështetjes aktive të fushatës nga personat e ekspozuar në foto, por ngjarje të vizitave zyrtare të Elbert Krasniqi't si Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, ashtu që të njëjtat nuk përbëjnë "angazhim" dhe as "pjesëmarrje" të personave nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë, sepse nuk përfshijnë asnjë formë veprimi aktiv nga ana e tyre, që do të mund të interpretohej si "angazhim" apo "pjesëmarrje" në fushatë.

Marrë parasysh të lartcekurat e kundërshtojmë në tërësi ankesën e palës ankuese dhe kërkojmë që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës, Elbert Krasniqi, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik PLE, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkuara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar neni 5 paragrafi 3 parasheh se "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve."

Neni 4, parashih se “*personat të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç deri tetëmbëdhjetë (18), ju lejohet përfshirja në aktivitetet e fushatës vetëm me vullnetin e tyre dhe pas orarit të mësimin.*”

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, konkretisht neni 5 paragrafin 2.


Sepse në rastin konkret bazuar nga provat e ofruara vërtetohet se fotot e ekspozuara janë të realizuara nga aktivitetet zyrtare të MAPL dhe jo nga fushata, respektivisht të njëjtat janë foto nga inaugurimi i projektit "komunat për të rinjtë" dt. 22.12.2022 dhe dt. 31.04.2024, nuk përmbajnë ndonjë simbol zgjedhor apo ndonjë slogan të fushatës dhe se fotot nuk janë të ripostuara gjatë kohës së fushatës zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.134/2025 datë 23.01.2025

Kryesues i Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.